



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.596/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci, kryesues, Rustem Thaçi dhe Faton Ademi, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Flamur Isufaj me vendbanim në Gjermani, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 02.09.2021, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet i bazuar apeli i ushtruar nga Flamur Isufaj me vendbanim në Gjermani, Detyrohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, që apeluesin ta regjistroi si votues në listën e votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahen, me datën 17 tetor 2021.

A r s y e t i m

Me datën 01.09.2021 PZAP-i ka pranuar një apel nga Flamur Isufaj me vendbanim në Gjermani, në të cilën pretendohet se i ka plotësuar të gjitha kushtet për regjistrim si votues jashtë shtetit mirëpo në bazë të listës zgjedhore i njëjti nuk gjindet në këtë listë, andaj kërkon nga PZAP-i që të përfshihet në këtë listë.

Parashtruesi i apelit si dëshmi ka bashkangjitur dokumentin identifikues-pasaportën dhe formularin e aplikimit në emër të tij.

Me datë 01.09.2021 PZAP ka parashtruar kërkesë për përgjigje pranë KQZ, me të cilën ka kërkuar që të njoftohet lidhur apelin e parashtruar nga pala ankuese deri me datë 02.09.2021 në ora 10:00.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve brenda afatit kohor ka paraqitur përgjigje në kërkesë në të cilën ka theksuar se nga e-mail adresa "fatmir-isufaj@hotmail.com" kemi pranuar aplikacionin për regjistrim për Flamur Isufaj, me datën 9 gusht 2021, në e-mail adresën vjk.kqz@kqz-ks.org. Për arsye të lëshimeve gjatë procesit të shtypjes së aplikacioneve, aplikacioni i dërguar brenda afatit për Flamur Isufaj, i plotëson të gjitha kriteret për përfshirje në listën e votuesve jashtë Kosovës.

Paneli pasi që shqyrtoi apelin konstatoi:

Apeli është i bazuar

Nga provat e bashkangjitura nga parashtruesi i apelit, e që janë pasaporta valide e Republikës së Kosovës në emër të tij, si dhe nga përgjigja e KQZ-së, në të cilën theksohet se Flamur Isufaj i plotëson të gjitha kriteret për përfshirje në listën e votuesve jashtë Kosovës. Paneli gjeti se këto dëshmi janë të mjaftueshme për të vërtetuar se Flamur Isufaj, i plotëson kushtet ligjore për tu përfshirë në Listën e Votuesve Jashtë Kosovës. ashtu siç parashihet në kuptim të nenit 5.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme/Lokale (LZP), prandaj në bazë të nenit 118.1 të LZP-së lidhur me nenin 10.7 të Rregullës Zgjedhore nr. 2/2015, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 596/2021 më datën 02.09.2021



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.